



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.17.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË PËR
FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR
MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Jusuf Kryeziu (Udhëheqësi i Ekipit), dhe Arta Birinxhiku, Ajtene Llapashtica dhe Burbuqe Idrizi (Anëtarë të Ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	18
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	19
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	21
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 26.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm me stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit".

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Ministrit - auditimi 2016

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e MFSK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është

përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Forcës dhe Sigurisë së Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Forcës dhe Sigurisë së Kosovës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MFSK, kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MFSK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha Organizatat Buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të plotësuar për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në MFSK në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. MFSK ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Ne duhet të theksojmë që Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në vazhdimësi tregon një cilësi të lartë të punës përmes së cilës jep vlerësime të qëndrueshme lidhur me funksionimin e kontrolleve në organizatë. Në këtë aspekt, përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm duhet të merret në konsideratë nga menaxhmenti i MFSK-së për përmirësimin e fushave me mangësi të theksuara.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2015, ka rezultuar me pesë (5) rekomandime. MFSK ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet zbatohen brenda periudhës së specifikuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, tri (3) rekomandime janë zbatuar plotësisht, përderisa dy (2) janë në proces të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë zbatuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Menaxhmenti i MFSK-së ka ndërmarrë masa për t'i zbatuar rekomandimet e vitit paraprak (2015). Ne veçanti ka progres në fushën e shpenzimeve. Mirëpo në fushën e menaxhimit të personelit (mirëmbajtja e dosjeve) ka mungesë të zbatimit të rekomandimeve.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontroleve dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.
- Rekomandimi 1** Ministri duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Për rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për OB-të për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për MFSK-në të cilat se bashku me të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi. Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij, dhe kemi vërejtur se:

- MFSK, ka hartuar planin vjetor dhe strategjik të saj, ka përcaktuar strategji të përgjithshme të objektivave, si dhe janë qartësuar përgjegjësitë për koordinim dhe zhvillim të planit strategjikë; dhe
- MFSK ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve, duke e hartuar planin detaj për trajtimin e rreziqeve të organizatës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MFSK operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Menaxhmenti i MFSK-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Procesi i raportimit të brendshëm në MFSK funksionon sipas zinxhirit llogaridhënës dhe atij komandues të parashikuar me ligjin dhe strukturën organizative të MFSK-së dhe FSK-së. Lidhur

me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj. Temat dhe konkluzionet e takimeve ishin pasqyruar në procesverbalet e rregullta.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre (3) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy (2) auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MFSK dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit efektiv.

Kjo njësi për vitin 2016 ka planifikuar dhe realizuar tetë (8) auditime të cilat kanë mbuluar fushat kryesore. MFSK kishte përgatitur plan për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-it dhe është në proces për zbatimin e tyre. Gjithashtu NjAB ka raporte tremujore për aktivitetet e saj në NjQHAB në MF.

Vlerësimi ynë është se raportet e NjAB-së janë cilësore dhe menaxhmentit i kanë ofruar pasqyrë të qartë mbi nivelin e funksionimit të kontrolleve të brendshme, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MFSK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor marrë si tërësi janë të mira. MFSK ka arritur të realizoj po thuaj në tërësi buxhetin final (mbi 99.6%) për vitin 2016.

Më tutje, performanca e menaxhimit të shpenzimeve këtë vit është përmirësuar edhe më tej, në raport me vitet tjera. Auditimi ynë i këtij viti nuk ka identifikuar ndonjë mangësi domethënëse në menaxhimin e përgjithshëm të shpenzimeve, më përjashtim të disa dobësive të cilat përfshijnë kryesisht personelin dhe prokurimin.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	49,250,008	44,025,330	43,872,641	39,658,494	39,511,052
Granti i Qeverisë -Buxheti	49,250,008	44,015,330	43,862,855	39,658,494	39,511,052
Donacionet e brendshme	-	10,000	9,786	-	-

Buxheti final ishte më i vogël se buxheti fillestar për 5,224,678€. Sqarimet lidhur me ndryshimet në buxhetin final të MFSK-së janë dhënë poshtë tabelës 2.

Në vitin 2016, MFSK ka përdorur 99.65% të buxhetit final ose 43,872,641€. Me një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2015. Në përgjithësi ekzekutimi i buxhetit për këtë vit ishte i mirë.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	49,250,008	44,025,330	43,872,641	39,658,494	39,511,052
Pagat dhe Mëditjet	21,803,188	21,206,515	21,071,464	19,791,897	17,308,548
Mallrat dhe Shërbimet	8,963,805	8,191,666	8,190,467	8,333,078	9,419,564
Shërbimet komunale	803,015	814,916	802,211	812,100	819,569
Investimet Kapitale	17,680,000	13,812,232	13,808,498	10,721,419	11,963,371

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 596,673€. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos rekrutimit të stafit të lejuar për vitin 2016. Buxheti për këtë kategori për 2016 është shpenzuar 99.36%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 772,139€ (me rishikim është zvogëluar për 336,870€, ndërsa në atë final për 435,269€). Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar rreth 100%.
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar është rritur për 11,901€ (me rishikim është rritur për 50,000€, ndërsa në atë final është zvogëluar për 38,099€). Buxheti final është shpenzuar rreth 98.44%.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 3,867,768€ (me rishikim është zvogëluar për 1,399,650€, ndërsa në atë final për 2,468,118€). Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe pesë (5) projekte të reja për vitin aktual. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar rreth 100%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e MFSK-së. Në këtë kategori janë shpenzuar afro 100% të buxhetit final (ref: tabela nr.2).

Megjithatë ne identifikuam dobësi në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit. Kjo është shpalosur në vijim:

Çështja 2 – Mirëmbajtje jo e mirë e dosjeve të personelit – Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Si rezultat i ekzaminimit të dosjeve, në tri (3) prej tyre dosjet nuk ishin plotësuar me të gjitha dokumentet e kërkuara. Kryesisht mungonin disa prej dokumenteve siç janë: kualifikimet (diploma), pushimet, vlerësimet e performancës si dhe përshkrimi i detyrave të punës.
- Rreziku** Mangësitë e paraqitura në mirëmbajtjen e dosjeve mund të humbin besueshmërinë ndaj kontrolleve në personelin e MFSK-së. Mos përshkrimi i detyrave/përgjegjësive të punësuarve mund të krijojë paqartësi gjatë punës, përderisa mos kryerja e vlerësimit të punës për të punësuarit, mund të ketë efekt negativ në performancën e tyre dhe të organizatës në përgjithësi. Kjo gjithashtu pamundëson identifikimin e fushave për përmirësim dhe zhvillimin e të punësuarve.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të sigurojë që të gjitha dosjet e personelit janë të plotësuara në përputhje me legjislacionin dhe azhurnohen me qëllim të përforcimit të kontrolleve të brendshme. Me tutje të sigurojë përshkrim të qartë të detyrave dhe përgjegjësive për të gjithë punonjësit e organizatës me qëllim të ngritjes së performancës së tyre dhe organizatës në përgjithësi.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe buxhetin për shërbime komunale në vitin 2016 ishte 9,006,582€, Prej tyre janë shpenzuar 8,992,679€, ose afro 100%. Ne kemi ekzaminuar disa mostra dhe kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë, të cilat shpalosen çështjen në vijim:

Çështja 3 – Vonesë ne procedurën për vlerësimin e tenderit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Në lëndën “Furnizim me material ndërtimor dhe pajisje për mirëmbajtje te objekteve të infrastrukturës përcjellëse të FSK-së”-Lot II, procesi i hapjes së tenderit është bërë më datë 15.04.2016, ndërsa procesi i vlerësimit i filluar me datë 21.04.2016, ka përfunduar me datë 21.06.2016, apo me 30 ditë vonesë.
- Rreziku** Vonesat në zhvillimin e procedurave të vlerësimit, rrisin rrezikun për mos arritjen e objektivave të organizatës. Vonesat në realizimin e projekteve gjithashtu mund të rezultojnë në rritjen e obligimeve në fund të vitit, të cilat mund të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të përmirësoj nivelin e kontrolleve në mënyrë që vlerësimi dhe realizimi i projekteve të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj.
-

3.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 13,812,232€. Prej tyre në 2016 janë shpenzuar 13,808,498€, ose 100%. Në këtë kategori kemi ekzaminuar disa mostra ku kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë. Si rezultat i ekzaminimit të këtyre mostrave doli që:

Çështja 4 - Planifikim jo i mirë i buxhetit për aktivitetin e prokurimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Ligji i buxhetit për vitin 2016, përcakton lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital (Tabela 3.2) në tjetrin brenda nën programit të njëjtë të OB-së. Nëse kërkesa për alokime është mbi 25% të shumës së buxhetuar atëherë kërkohet aprovimi nga Kuvendi.

Në lëndën “Furnizim me pajisje për çminim për nevojat e FSK-së” Lot II, planifikimi për këtë kontratë ishte 50,000€, ndërsa kontrata është nënshkruar me vlerë 98,856€, ose për afro 100% me e lartë. Lidhur me këtë nuk janë respektuar procedurat e ligjit të buxhetit.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit për projekte të caktuara si dhe pagesa e tyre shumë më e lartë se mjetet e ndara, pamundëson realizimin e të gjitha projekteve të përcaktuara në tabelën e buxhetit, e me këtë edhe realizimin e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të shtojë masat e kontrollit mbi njësitë e planifikimit, që gjatë hartimit të buxhetit për projekte kapitale të bëhet një llogaritje e arsyeshme dhe reale si dhe analizë më detaje e çmimeve të tregut. Bazuar në këtë planifikimi mund të jetë më i përafërt me realizimin e kontratave. Me tutje në rastet e tejkalimeve prej 25% të kërkohet aprovimi nga Kuvendi.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 152,744,765€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) është 1,846,027€ si dhe stoqet në vlerë prej 322,182€.

Ne kemi ekzaminuar disa mostra në këtë kategori, ku kemi aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë. Gjithashtu kemi kryer ekzaminim fizik të pasurisë për të verifikuar ekzistencën e tyre.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

MFSK, ka shpalosur obligimet e papaguara në PVF-të për vitin 2016 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013/MF për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore.

Vlera e obligimeve të shpalosura në PVF-të e vitit 2016 ishte 462,578€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Në raport me vitin 2015, MFSK ka treguar progres në menaxhimin e faturave të papaguar, duke reduktuar obligimet në fund të vitit për 17% (obligimet e papaguara në fund të vitit 2015 ishte 542,583€).

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP-ja, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të AP-së, mangësi të njëjta janë prezentë në fushën e menaxhimit të personelit.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri, duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me nivelin e dobët të planifikimit të buxhetit. Ai duhet të sigurojë se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një analizë e detajuar e cila pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar/ndryshimet e pritura të vitit, etj. Performanca e buxhetit duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuara në ekzekutimin e niveleve të planifikuara të buxhetit me fokus të veçantë në projektet kapitale.	Po		
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në menaxhimin e kontratave (respektimin e afateve kohore në realizimin e tyre) përfshirë edhe realizimin e pagesave. Në të kundërtën të aplikohen të gjitha ndëshkimet në pajtueshmëri të plotë me kushtet e kontratës.	Po		
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të përforcojë edhe më tej procedurat gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe nënshkrimit të kontratave, që të sigurohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.	Po		

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë që dosjet e personelit janë azhurnuar me kohë, si dhe vlerësimet vjetore të performancës të kryhen dhe dokumentohen për të gjithë të punësuarit rregullisht. Në këtë mënyrë, krijohet baza për të shpërblyer të punësuarit sipas meritës dhe identifikohen fushat për përmirësim, e cila mundëson hartimin e një programi për zhvillimin e mëtutjeshëm të stafit. Më tutje të siguroj se rekomandimi i dhënë në vitet paraprake lidhur me ndërprerjen e punësimeve me kontrata të përkohshme të adresohet plotësisht.		Është treguar progres në menaxhimin e personelit, megjithatë ende mbetet sfidë për MFSK-në kompletimi i dosjeve të personelit.	
--	--	--	--	--

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS - MINISTRIJA ZA KOSOVAKIM SNAGA I BEZBEDOSNE - MINISTRY OF KOSOVO SECURITY FORCE ZYRA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM - KANCELARIJA PËRMANENTË SECRETARAT-OFFICE OF THE PERMANENT SECRETARY			
Nr. Dreg. Org. Adresa Org. Unit	217	Nr. Post. Org. Post. Post. Nr.	1139
Nr. Letere Pro. Strana Nr. Jopis	1	Data Datum Date	16.05.2017
Prishtinë / n			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Generalnog Sekretara / The office of General Secretary

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Shkelzen Sylaj



Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës,

Data: 16/05/2017, Prishtinë,

Faqe 1 nga 1